

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“FourA” sh.p.k

Sot me date 19.02.2025, ne Lezhe ne mbeshtetje te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoqerite tregatre”, u hartua ky akt themelim nga ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar:

1. **Z. Ali GASHI** me atesi Adem, i datelindjes 11.10.1960 lindur ne Peje, banues ne Prishtine, Kosove i identifikuar me pasaporte te Republikes se Kosoves me numer personal 1000300345 dhe Pasaporte nr. P01104626.

Si me poshte vijon :

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “FourA” sh.p.k. Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionit Shqipetar dhe ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Lezhe, Lezhe, Njësia administrative Shënkoll, Fshati Grykë Lumi, zona kadastrale nr. 1879, numer pasurie 49/333/3+1-14.
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj vetem me vendim te asamblese se ortakeve.

Forma e Shoqerise

Neni 3

Forma juridike e shoqerise eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.

Objektivi i Veprimtarise


Neni 4

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:
Ne fushen e ndërtimit si ndërtim të ndërtesave dhe komplekse banuese. Shit-blerje te pasurive të paluajtshme si toka, shtëpi etj.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pa kufizuar (e pacaktuar) duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Me perjashtim te rasteve te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara ne ligj ose me vendim te asamblese se ortakeve.



Kapitali i Shoqerise

Neni 6

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 000 Leke (*Njeqindmije*) i perbere nga 1 (nje) kuote.

- Ali GASHI zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Shoqeria mund te shtojë ose te zvogelojë kapitalin, ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj, sipas vendimit te asamblese se ortakeve.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i nje ortaku.

Drejtimi i Shoqerise

Asambleja e Ortake

Neni 7

Asambleja e Ortakeve i ushtron te gjitha kompetencat qe i njihen me ligj per shkak te kesaj cilesie.

Perfaqesuesi i Shoqerise

Administratori

Neni 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj z. Ali GASHI me atesi Adem, i datelindjes 11.10.1960 lindur ne Peje, banues ne Prishtine, Kosove i identifikuar me pasaporte te Republikes se Kosoves me numer personal 1000300345 dhe Pasaporte nr. P01104626. Ai eshte perfaqesuesi i shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme.

Fitimi

Neni 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve te kesaj shoqerie sipas kontributit dhe pjeseve takuese qe kane ne kete shoqeri.

Bilanci

Neni 10

Viti financiar Fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel miratohen nga asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Konfliktet

Neni 11

Konfliktet qe mund te lindin ndermjet paleve do te gjykohen ne Gjykatën e Shkalles se pare, sipas statutit te shoqerise, kontrates se lidhur ndermjet paleve dhe ne zbatim te legjislacionit Shqiptar.

Vula dhe shenjat dalluese

Neni 12

Shoqeria ka vulen dhe shenjat dalluese te saj.

Neni 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare". Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi marrjes se lejes nga organet kompetente.

Neni 14

Akti i themelimit u perpilua ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe me vlere te njejte, dhe nenshkruhet rregullisht nga ortakët.

Ortaku i Vetem Themelues

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

** FourA **



Ali GASHI
Emer mbiemer
(nenshkrimi)

